



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 182/2 prot.

Gramsh, më 03/02/2022

VENDIM

Nr. 6 dt. 30/01/2023

PËR

“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara forca madhore (tërmeti) i datës 26.11.2019 dhe përkeqësimin e gjëndjes aktuale të objektit në banesën e shtetasit Asqeri Taragjini lagja Sporti 2, bashkia Gramsh si dhe dëmshpërblimin financiar të kësaj familje”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 30.01.2023, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga forca madhore (tërmeti) I datës 26.11.2019, si dhe përkeqësimi I gjëndjes aktuale nga kushtet e këqija atmosferike të banesës së shtetasit Asqeri Taragjini, banues në lagjen Sporti 2, Bashkia Gramsh, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 nga forca madhore (tërmeti) i datës 26.11.2019, si dhe përkeqësimi i gjëndjes aktuale nga kushtet e këqija atmosferike, për shtetasin **Asqeri Taragjini** në vlerën **120 000** (një qind e njëzetë mijë) lekë.
3. Ti akordoj familjes së shtetasit **Asqeri Taragjini** , ndihmën emergjente në vlerën **120 000** (një qind e njëzetë mijë) lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2023.
4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Asqeri Taragjini, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori i Emergjencave Civile), si dhe Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financar.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI



Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Konfirmoi: G. Lena
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes:

KRYETARI i Këshillit të Bashkisë

GRETA LENA

